



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4699/1 Prot.

MINISTRI

Tiranë, më 30.04. 2019

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo rregullore mbështetet në Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

**Neni 2
Qëllimi**

Kjo rregullore ka qëllim të përcaktojë rregullat për organizimin, menaxhimin, kompetencat dhe funksionimin e brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoreve Rajonale të Arsimit Parauniveristar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniveristar.

**Neni 3
Përkufizime**

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

DPAP - Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

MASR - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

ASCAP - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimit Parauniversitar.

DRAP - Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

ZVAP - Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.

**Neni 4
Statusi**

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) janë krijuar me VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
- b) DPAP-ja është person juridik, publik, buxhetor, që zhvillon aktivitetin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- c) DPAP-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.
- d) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë përfaqësohet në nivel rajonal nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të cilat janë në varësi administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).
- e) ZVAP-të funksionojnë si njësi të ofrimit direkt të shërbimeve dhe janë në varësi administrative të DRAP-ve.

Neni 5 Misioni

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

Neni 6 Parimet kryesore

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë DPAP-ja bazohet në këto parime:

- a) Parimi i barazisë: të gjithë qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, arsimit, etnisë, gjendjes ekonomike e sociale, bindjeve politike e fetare, etj.
- b) Parimi i ligjshmërisë: të gjithë punonjësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, janë të detyruar të zbatojnë Kushtetutën dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Askujt nuk i lejohet shmangia nga detyrimet ligjore, mosbatimi i ligjit apo zbatimi i gabuar i tij, për shkak të padjenisë së ligjit.
- c) Parimi i vazhdimësisë: detyrat e ndjekura nga nëpunësit e mëparshëm që janë larguar nga detyra, do të vazhdojnë të realizohen nga nëpunësit e rinj në vijimësi dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.
- d) Parimi i transparencës: punonjësit e DPAP-ve, në veprimtarinë e tyre duhet të ushtrojnë kompetencat funksionale në mënyrë transparente, duke garantuar bashkëpunim të ngushtë me persona fizikë dhe juridikë të përfshirë në të gjitha vendimet që marrin apo veprimet që kryejnë.
- e) Parimi i ndershëmërisë: të gjithë punonjësit, detyrohen të trajtojnë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjithë subjektet me të cilët hyjnë në marrëdhënie për shkak të detyrave apo kompetencave të tyre, duke zbatuar me rigorozitet parimet e etikës në administratën publike.

- f) Parimi i bashkëpunimit: të gjithë strukturat dhe të gjithë punonjësit duhet të sigurojnë bashkëpunimin për realizimin e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve të përbashkëta sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
- g) Parimi i ndalimit të konfliktit të interesave: asnjë punonjës i DPAP-së nuk mund të jetë pjesë e një procesi vendimmarrës, nëse kjo ndalohet nga dispozitat e Ligjit 44/2015 “Kodit të Procedurave Administrative” dhe Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 për “Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

**Neni 7
Organizimi**

DPAP-ja është e organizuar në:

- a) nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- b) nivel rajonal, nëpërmjet drejtive rajonale të arsimit parauniversitar;
- c) njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik.

**Neni 8
Rekrutimi, vlerësimi, etika,
dhe largimi nga detyra i punonjësve të DPAP, DRAP dhe ZVAP**

Mënyra e rekrutimit, vlerësimit dhe largimit nga detyra të punonjësve të DPAP, DRAP dhe ZVAP do të kryhet mbi bazën e rregullores së miratuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

**KREU II
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**Neni 9
Përgjegjësitë e DPAP**

DPAP-ja ka këto përgjegjësi kryesore:

1. Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
2. Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institacioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike të arsimit parauniversitar të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Të vlerësojë përbushjen e kritereve të licencimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institacioneve arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe t'i propozojë ministrit dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë.

6. Të vlerësojë nëpërmjet DRAP-ve dhe ZAVP-ve, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të shqyrtojë për përbushjen e kritereve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.

Neni 10 **Organizimi**

DPAP-ja, është têrësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor parauniversitar.

DPAP-ja organizohet në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 668, datë 05. 04. 2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtive Rajonale të Arsimit Parauniveristar”.

Neni 11 **Detyrat e DPAP**

DPAP-ja ka këto detyra:

- a) Bashkërendon zbatimin e politikave, strategjive të zhvillimit, programeve, projekteve, kuadrin rregullator dhe kurrikulën në fushën e arsimit parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- b) Siguron, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore arsimore, inspektimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimit dhe të sistemit arsimor parauniversitar.
- c) Analizon dhe përcakton kostot e realizimit të shërbimeve arsimore, duke mbledhur e përpunuar të dhëna nga drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe institucionet arsimore.
- d) Mbështet institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar (ASCAP) për zbatimin e dokumenteve kurrikulare, për zhvillimin profesional, për organizimin e kualifikimit të punonjësve arsimorë dhe për mbledhjen e të dhënavë statistikore në sistemin e arsimit parauniversitar.
- e) Në përputhje me analizat e kryera, planifikon organizimin dhe shtrirjen e shërbimit arsimor, programon punën, siguron dhe optimizon burimet për ofrimin e shërbimeve arsimore parauniversitare, si dhe planifikon buxhetin në terma afatshkurtër e afatmesëm për institucionet publike të arsimit parauniversitar.
- f) Siguron mbledhjen, plotësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënavë statistikore për institucionet arsimore, sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- g) Mbështet ministrinë dhe institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar me të dhëna, ekspertizë teknike dhe propozime në hartimin e politikave të zhvillimit në fushën e arsimit parauniversitar, duke marrë parasysh veçoritë demografike, të terrenit, të zhvillimit ekonomik e të infrastrukturës vendore.
- h) Organizon dhe monitoron në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar procesin e përzgjedhjes, si dhe shpërndarjen dhe pajisjen e

institucioneve arsimore me tekste shkolllore dhe raporton në MASR për monitorimin e kryer.

- i) Siguron koordinimin e veprimtarive të drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar
- j) Koordinon administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi.
- k) Drejton dhe mbikëqyr procedurat e punësimit të mësuesve në institucionet e arsimit parauniversitar nëpërmjet Portalit Mësues për Shqipërinë.

Neni 12

Funksionimi

1. DPAP-ja drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e drejtorisë qendrore. Drejtori i Përgjithshëm për të gjithë veprimtarinë e tij, përgjigjet dhe raporton përpara Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm në MASR.
2. Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:
 - a) Kontrollon dhe garanton përbushjen e misionit dhe objektivave të drejtorisë dhe të detyrimeve që ka drejtoria qendrore dhe DRAP-ja.
 - b) Përfaqëson drejtorinë në marrëdhëniet me të tretët, si dhe autorizon personat që mund të përfaqësojnë drejtorinë në mungesë të tij.
 - c) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e drejtorisë, nëpërmjet akteve të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e drejtorisë.
 - d) Përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për arsimin për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe përpara Sekteratit të Përgjithshëm për sigurimin e mbarëvajtjes së administrimit financiar, burimeve njerëzore, veprimtarisë arkivore, dokumentare dhe aktiveve të drejtorisë qendore në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
 - e) Merr në shqyrtim dhe adreson rekomandimet e brendshme apo të jashtme me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave të zbatuara nga punonjësit e drejtorisë.
 - f) Informon në mënyrë periodike ministrin përgjegjës për arsimin dhe Sekretarin e Përgjithshëm për problemet e ndryshme në lidhje me planet e punës apo arritjen e objektivave.
 - g) Kryen delegimin e detyrave në drejtorinë qendore, mbi çështjet që i drejtohen për trajtim dhe zgjidhje.
 - h) Zbaton urdhrat e Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MASR-së, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - i) Koordinon dhe mbikqyr veprimtarinë e sektorëve të drejtorisë qendrore
 - j) Drejton dhe mbikqyr veprimtarinë e drejtorive rajonale.
 - k) Raporton te Ministri Përgjegjës për Arsimin, mbi verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së drejtorive arsimore rajonale, zyrave vendore dhe institucioneve arsimore parauniversitare (publike dhe private) me aktet ligjore/nënligjore.
3. DPAP-ja ka lidhje funksionale bashkëpunimi me institucionet e tjera të sistemit arsimor parauniversitar në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 13 Organizimi i punës

DPAP-ja zhvillon veprimtarinë e saj, nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës, Sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional dhe Sektorit të Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, bazuar në përshkrimet e vendeve të punës për secilën strukturë.

Neni 14

Detyrat kryesore të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës

- a) Harton projektbuxhetin e drejtorisë qendore, si dhe planifikon buxhetin në terma afatshkurtër e afatmesëm për DRAP, ZVAP dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.
- b) Përpilon listë-prezencat, përgatit listë-pagesat dhe përditëson data bazën për punonjësit e DPAP, si dhe koordinon administrimin e burimeve njerëzore në nivel drejtoria rjonale dhe zyre vendore të arsimit parauniversitar.
- c) Realizon dhe mban shpenzimet operative të DPAP-së.
- d) Siguron, përpunon dhe administrojn, sipas kërkesës së MASR-së, të dhënat statistikore nga drejtoritë rjonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar.
- e) Siguron që planifikimi, zbatimi dhe raportimi financiar për institucionet publike të arsimit parauniversitar të kryhet sipas legjislacionit në fuqi.
- f) Monitoron procesin e deklarimit të vendeve të lira të punës në të gjithë sistemin e arsimit parauniveristar dhe procedurat e rekrutimit të drejtorëve, nëndrejtorëve dhe mësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare publike. Për çdo shkelje të konstatuar, i paraqet nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, raportet e inspektimit dhe rekomandimet përkatëse, sipas rastit.
- g) Kontrollon administrimin, inventarizimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe infrastrukturës.
- h) Siguron asistencë juridike dhe përfaqësimin gjyqësor për DPAP-në.

Neni 15

Detyrat kryesore të Sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional

- a) Drejton zbatimin e politikave dhe strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.
- b) Drejton zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar në bashkëpunim me drejtoritë rjonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar.
- c) Drejton procesin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë.
- d) Identifikon në bashkëpunim me drejtoritë rjonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar nevojat për zhvillim profesional të mësuesve.
- e) Mbështet zbatimin e projekteve në fushën e kurrikulës dhe të zhvillimit profesional të mësuesve.

Neni 16

Detyrat kryesore të Sektorit të Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë

- a) Verifikon pajtueshmërinë e veprimtarisë së drejtorive arsimore rajonale, zyrave vendore dhe institucioneve arsimore parauniversitare (publike dhe private) me aktet ligjore/nënligjore dhe raporton te Drejtori i Përgjithshëm.
- b) Inspekton, monitoron dhe vlerëson veprimtarinë dhe zbatueshmërinë e akteve ligjore nga drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe institucionet e arsimit parauniversitar, dhe i paraqet nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, raportet e inspektimit dhe rekomandimet përkatëse, sipas rastit.
- c) Garanton respektimin dhe zbatimin e procedurave ligjore në plotësimin e nevojave të institucioneve arsimore për dokumentacion shkollor, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe udhëzimeve të MASR-së.
- d) Monitoron zbatimin e procedurave ligjore në administrimin e burimeve njerëzore nga drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe institucionet e arsimit parauniversitar, dhe i paraqet nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, raportet e inspektimit dhe rekomandimet përkatëse, sipas rastit.
- e) Vlerëson në bashkëpunim me drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar cilësinë e shërbimit arsimor që ofrohet nga institucionet arsimore publike dhe private, dhe i paraqet nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, raportet e inspektimit dhe rekomandimet përkatëse, sipas rastit.
- f) Propozon masa sipas gjetjeve të inspektimit, si dhe kontrollon zbatimin e masave të dhëna nga MASR-ja.

Neni 17 **Raportimi**

- a) DPAP-ja harton planin afatmesëm dhe planin vjetor të punës i cili miratohet nga Ministri i MASR-së.
- b) DPAP-ja çdo vit paraqet në MASR reportin vjetor të veprimtarisë dhe reportin finanziar.
- c) Raporti vjetor i DPAP-së u dërgohet institucioneve arsimore, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe publikohet në faqen zyrtare të saj.
- d) DPAP-ja zhvillon analizën vjetore me pjesëmarrjen e drejtuesve të institucioneve arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe me përfaqësues të sindikatave, OJF-ve dhe enteve publike dhe jopublike të tjera që veprojnë në fushën e arsimit parauniversitar.

Neni 18 **Faqja zyrtare**

- a) DPAP-ja ka faqen e saj zyrtare elektronike.
- b) DPAP-ja publikon në faqen zyrtare të saj të dhënat për arsimin parauniversitar.
- c) DPAP-ja publikon të dhëna të vlerësimeve dhe provimeve kombëtare e ndërkombëtare.
- d) DPAP-ja publikon reportin vjetor në faqen zyrtare të internetit.
- e) DPAP-ja publikon rregullisht në faqen e internetit përvojat e suksesshme të institucioneve arsimore, drejtuesve dhe mësuesve.

- f) Shpall njoftimet për vendet vakante.
- g) Shpall listën e mësuesve të renditur në portalin Mësues për Shqipërinë.

KREU III
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 19
Përgjegjësitë e Drejtive Rajonale të Arsimit Parauniveristar

Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniveristar, janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore brenda juridikzionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal.

Neni 20
Organizimi

DRAP-ja është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, e cila kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim cilësor në arsim. DRAP-ja organizohet në zbatim të urdhrit të Kryeministrat nr. 668, datë 05.04.2019 “Përmiratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniveristar”.

Neni 21
Detyrat e DRAP

DRAP-të kanë këto detyra:

- a) Sigurojnë zbatimin e kurrikulës, metodologjitet dhe standarde që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor.
- b) Ofrojnë ekspertizë teknike në hartimin e metodologjive mësimore, praktikave dhe teknikave që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
- c) Menaxhojnë dhe mbikëqyrin/kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare lidhur me zhvillimin e veprimitarive mësimore.
- d) Monitorojnë kualifikimet e personelit mësimdhënës për kurrikulen, metodologjitet dhe standarde e përcaktuara nga institucioni përgjegjës.
- e) Garantojnë miradministrimin e burimeve njerëzore për institucionet publike të arsimit parauniversitar, si dhe shpërndarjen e tyre në varësi të aftësive, kontributit të gjithësecilit dhe parimeve të drejtësisë e meritokracisë.
- f) Garantojnë ngritjen e rrjetave profesionale të mësuesve si dhe përhapin praktikat dhe përvojat e suksesshme të mësuesve të institacioneve arsimore.
- g) Janë përgjegjëse për rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit, mirëmbajtjes, përditësimit të portalit kombëtar “Mësues për Shqipërinë”, ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimin e analizimin e të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.
- h) Garantojnë mirëadministrimin e burimeve financiare dhe alokimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore bazuar në formulën “për nxënës”.

- i) Bashkëpunojnë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore.
- j) Monitorojnë procedurat për përgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
- k) Organizojnë dhe mbështesin zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar.
- l) Inspekojnë, monitorojnë, vlerësojnë, rekomandojnë dhe nxjerrin përfundime mbi zbatueshmërinë e kritereve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private.
- m) Mbledhin dhe përpunojnë të dhënat statistikore nga institucionet arsimore nën juridikcionin e tyre.
- n) Sigurojnë për zyrat vendore të arsimit parauniversitar që ka nën juridikcion, asistencë juridike dhe përfaqësimin gjyqësor, nëpërmjet juristëve të DRAP-ve dhe/ose juristëve të ZVAP-ve, si dhe shërbimet financiare dhe mbështetëse.

Neni 22

Funksionimi

DRAP-ja drejtohet nga Drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e drejtorisë. Drejtori raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP-së, si edhe përgjigjet përpara Ministrit dhe Sekteratit të Përgjithshëm në MASR, për të gjithë veprimtarinë e tij.

Drejtori i DARP-it ka këto kompetenca:

- a) Kontrollon dhe garanton përbushjen e misionit dhe objektivave të drejtorisë dhe të detyrimeve që ka drejtoria rajonale.
- b) Përfaqëson drejtorinë në marrëdhëni me të tretët, si dhe autorizon personat që mund të përfaqësojnë drejtorinë në mungesë të tij dhe/ose delegon përfaqësimin gjyqësor te juristët e DRAP-ve dhe ZVAP-ve.
- c) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e drejtorisë, nëpërmjet akteve të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e drejtorisë.
- d) Përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për arsimin për zbatimin e politikave, strategjive, programeve dhe projekteve në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe përpara Sekteratit të Përgjithshëm për sigurimin e mbarëvajtjes së administrimit finansiar, burimeve njerëzore, veprimtarisë arkivore, dokumentare dhe aktiveve të drejtorisë në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
- e) Raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP-së për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
- f) Merr në shqyrtim dhe adreson rekomandimet apo sugjerimet e brendshme apo të jashtme, me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave të zbatuara nga punonjësit e drejtorisë.
- g) Informon në mënyrë periodike Drejtorin e Përgjithshëm të DPAP-së, për problemet e ndryshme në lidhje me planet e punës apo arritjen e objektivave.
- h) Kryen delegimin e detyrave mbi çështjet që i drejtohen për trajtim dhe zgjidhje DRAP-it.
- i) Kordinon dhe mbikqyr veprimtarinë e sektorëve të drejtorisë rajonale.
- j) Drejton dhe mbikqyr veprimtarinë e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniveristar.
- k) Vlerëson kërkësat e ministrisë përgjegjëse për arsimin për përbushjen e kritereve infrastrukturore për hapjen e institacioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.

DRAP ka lidhje funksionale bashkëpunimi me institucionet e tjera të sistemit arsimor parauniversitar në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe/ose DPAP-së.

Neni 23 **Organizimi i punës**

DRAP-ja zhvillon veprimtarinë e saj, nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës, Sektorit të Kurrikulës, Zhvillimit Profesional, Sektorit të Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, bazuar në përshkrimet e vendeve të punës për secilën strukturë.

Neni 24 **Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës**

- a) Harton projektbuxhetin e DRAP-së dhe ZVAP-ve dhe ia propozon DPAP-së.
- b) Përpilon listë-prezencat, përgatit listë-pagesat dhe plotëson rregullisht dokumentacionin përkatës financiar të DRAP-së.
- c) Realizon dhe mban shpenzimet operative të DRAP-së.
- d) Harton listën çdo fillim muaji për emërimet e reja dhe personat që mbushin moshën dhe përfitojnë pension dhe i raportojnë në DPAP dhe MASR.
- e) Llogarit sipas formulës "për frymë" fondet e shtetit që i takojnë çdo institucioni arsimor për mallra dhe shërbime.
- f) Siguron të dhënat statistikore nga institucionet arsimore sipas kërkesave të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe kërkesave të DPAP-së.
- g) Përditëson data bazën e punonjësve arsimorë.
- h) Përputon dhe analizon të dhënat statistikore të grumbulluara.
- i) Përputon të dhënat përritjen e institucioneve arsimore.
- j) Dërgon të dhënat e përpunuara në DPAP dhe në sektorët e tjera të DRAP dhe ZVAP dhe në të gjitha institucionet arsimore.
- k) Drejton hartimin e raportit vjetor statistikor të DRAP.

Neni 25 **Detyrat e sektorit të Kurrikulës, Zhvillimit Profesional**

- a) Zbaton Strategjinë Arsimore në nivel DRAP dhe ZVAP.
- b) Bashkëpunon me MASR dhe institucionet e saj të varësisë për zbatimin e politikave dhe projekteve në shkolla.
- c) Organizon veprimtari të zhvillimit profesional për të përmirësuar aftësitë e drejtuesve të shkollave dhe mësuesve në fushën e kurrikulës.
- d) Ndjek plotësimin nga shkollat të parapëlqimeve të nxënësve në kurrikulen me zgjedhje.
- e) Këshillon drejtuesit, mësuesit lëndorë dhe ata kujdestare në fushën e kurrikules.
- f) Identifikon nevojat për zhvillim profesional të mësuesve përmes pyetësorëve, bisedave me ta, pjesëmarrjes në mbledhjet e ekipeve lëndorë, vizitave në institucione arsimore, vëzhgimeve të orëve mësimore, kryerjes me nxënësit të testeve të standardizuara e minitesteve, takimeve me prindër e nxënës e me organizma që i përfaqësojnë ato, me përfaqësues të tjera të komunitetit.
- g) Në bashkëpunim me organizma qeveritare ose joqeveritare, harton dhe zbaton projekte në fushën e kurrikulës në dobi të institucioneve arsimore dhe në bashkëpunim me to.

- h) Merr informacion mënyr nga shkollat mbi gjendjen e mjetave elektronike të TIK-ut dhe të laboratorëve të kompjuterëve, verifikon gjendjen dhe raporton në DRAP dhe DPAP.
- i) Mbikëqyr instalimin e pjesëve hardwerike të kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera
 - a. teknologjike dhe softwerezave.
- j) Mirëmban rrjetin LAN në DRAP dhe ZVAP mirëmban të gjitha pajisjet teknologjike të informacionit si dhe mirëmban shërbimin e internetit.
- k) Kontribuon që shërbimi i internetit dhe i laboratorëve të kompjuterëve në çdo shkollë të jetë në përputhje me parametrat e kontraktuara.
- l) Verifikon saktësinë e plotësimit të amzës së digjitalizuar nga shkollat.

Neni 26 **Detyrat e Sektorit të Inspektimit dhe i Vlerësimit të Cilësisë**

- a) Inspekton, monitoron, vlerëson, rekomandon dhe nxjerr përfundime mbi
 - a. zbatueshmërinë e kritereve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private dhe ZVAP-ja.
- b) Monitoron zbatimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në institucionet arsimore parauniversitare dhe në ZVAP.
- c) Propozon masa sipas gjetjeve të inspektimit dhe kontrollon zbatimin e tyre nga ZVAP dhe nga institucioni arsimor përkatës.
- d) Inspekton zbatimin e rregulloreve të Maturës Shtetërore dhe provimeve të arsimit bazë.
- e) Monitoron shpërndarjen dhe pajisjen me tekste të nxënësve
- f) Monitoron zbatueshmërinë e akteve normative për regjistrimin e nxënësve

Neni 27 **Raportimi**

- e) Secila DRAP harton planin afatmesëm dhe vjetor të punës i cili miratohet nga Drejtori i DPAP-së, si dhe raportin vjetor të veprimtarisë të cilin e paraqet në DPAP.
- f) Raporti vjetor i DRAP-së u dërgohet MASR-së, institucioneve arsimore, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe publikohet në faqen zyrtare të DPAP.
- g) DRAP-ja zhvillon analizën vjetore me pjesëmarrjen e drejtuesve të ZVAP, si dhe me përfaqësues të sindikatave, OJF-ve dhe enteve publike dhe jopublike te tjera që veprojnë në fushën e arsimit parauniveristar, në territorin nën juridikcionin e tyre.

Neni 28 **Faqja zyrtare**

- a) DRAP-ja ka faqen e saj zyrtare elektronike.
- b) DRAP-ja publikon në faqen zyrtare të saj të dhënat për arsimin parauniversitar.
- c) DRAP-ja publikon të dhëna të provimeve kombëtare e ndërkombëtare.
- d) DRAP-ja publikon raportin vjetor në faqen zyrtare të internetit.
- e) DRAP-ja publikon rregullisht në faqen e internetit përvojat e suksesshme të institucioneve arsimore drejtuesve dhe mësuesve.
- f) Shpall njoftimet për vendet vakante.
- g) Shpall listën e Portalit Mësues për Shqipërinë.

KREU IV
ZYRAT VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 29
Përgjegjësitë e Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksonit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor.

Neni 30
Organizimi

ZVAP, është tërësia e institucioneve ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare pjesë integrale e Drejtorisë Rajonale e Arsimit Parauniveristar, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor.

ZVAP organizohet në zbatim të Urdhërit të Ministrit të MASR nr. 234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniveristar”.

Neni 31
Detyrat e ZVAP

ZVAP-të kanë këto detyra:

- a) Monitorojnë zbatimin e kurrikulës, metodologjitë dhe standartet që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor dhe raportojnë në DRAP.
- b) Mbikëqyrin veprimtarinë e përditshme dhe funksionimin e institucioneve arsimore, përbushjen e detyrave administrative dhe rregullsinë e procesit mësimor.
- c) Vlerësojnë nevojat dhe problematikat gjatë ofrimit të shërbimit arsimor dhe propozojnë zgjidhjen e tyre.
- d) Menaxhojnë dhe mbikëqyrin/kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare lidhur me zhvillimin e proceseve dhe veprimtarive mësimore.
- e) Kryejnë miradministrimin e burimeve njerëzore për institucionet publike të arsimit parauniversitar, si dhe i propozojnë DRAP-it shpërndarjen e tyre në varësi të aftësive, kontributit të gjithësecilit dhe parimeve të drejtësisë e meritokracisë.
- f) Bashkëpunojnë për ngritjen e rrjeteve profesionale të mësuesve si dhe përhapin praktikat dhe përvojat e suksesshme të mësuesve të institucioneve arsimore.
- g) Bashkëpunojnë për rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit, mirëmbajtjes, përditësimit të portalit kombëtar “Mësues për Shqipërinë”, ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimin e analizimin e të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.
- h) Propozojnë miradministrimin e burimeve financiare dhe alokimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore bazuar në formulën “për nxënës”.
- i) Organizojnë dhe mbështesin shërbimin psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare publike për evidentimin e problematikave psiko-sociale të fëmijëve/nxënësve dhe zgjidhjen e tyre.

- j) Bashkëpunojnë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore dhe raprotnjë në DRAP.
- k) Monitorojnë procedurat për përgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore dhe raprotnjë në DRAP.
- l) Organizojnë dhe mbështesin zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar.
- m) Grumbullojnë të dhënat statistikore nga institucionet arsimore nën juridikcionin e tyre.
- n) Ofrojnë shërbime ndaj qytetarëve.

Neni 32 **Funksionimi**

1. ZVAP-ja drejtohet nga Drejtori i ZVAP, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e zyrës. Drejtori për të gjithë veprimtarinë e tij, përgjigjet përpara Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit Rajonal.
2. Drejtori i ZVPA-së, ka këto kompetenca:
 - a) Kontrollon dhe garanton përbushjen e misionit dhe objektivave të drejtorisë dhe të detyrimeve që ka ZVAP-ja.
 - b) Përfaqëson ZVAP-në në marrëdhënet me të tretët, si dhe autorizon personat që mund të përfaqësojnë zyrën në mungesë të tij.
 - c) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e zyrës, nëpërmjet akteve të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e zyrës.
 - d) Përgjigjet përpara Drejtorit të Përgjithshëm për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe raporton përpara Drejtorit Rajonal për sigurimin e mbarëvajtjes së administrimit financiar, burimeve njerëzore, veprimatrisë arkivore dhe dokumentare dhe aktiveve të zyrës në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
 - e) Merr në shqyrtim dhe adreson rekomandimet apo sugjerimet e brendshme apo të jashtme me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave të zbatuara nga punonjësit e Zyrës.
 - f) Informon në mënyrë periodike Drejtorin e DRAP-it, për problemet e ndryshme në lidhje me planet e punës apo arritjen e objektivave.
 - g) Kryen delegimin e detyrave mbi çështjet që i drejtohen për trajtim dhe zgjidhje ZVAP.
3. ZVAP-ja ka lidhje funksionale bashkëpunimi me institucionet e tjera të sistemit arsimor parauniversitar në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe/ose DPAP-së.

Neni 33 **Organizimi i punës**

ZVAP-ja zhvillon veprimtarinë e saj, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve, Sektorit të Kurrikulës, Zhvillimit Profesional, bazuar në përshkrimet e vendeve të punës për secilën strukturë.

Neni 34
Detyrat e Sektorit të Shërbimeve

- a) Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it.
- b) Përpilon listë-prezencat, përgatit listë-pagesat dhe kryen procedurat e tjera përkatëse për punonjësit e ZVAP dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publik, si dhe plotëson rregullisht dokumentacionin përkatës financiar.
- c) Realizon dhe mban shpenzimet operative të ZVAP-së.
- d) Realizon asistencën ligjore dhe përfaqësimin ligjor, sipas delegimit të DRAP.

Neni 35
Detyrat e Sektorit të Kurrikulës, Zhvillimit Profesional

- a) Këshillon drejtuesit, mësuesit lëndorë dhe ata kujdestarë në fushën e kurrikulës.
- b) Identifikon nevojat për zhvillim profesional të mësuesve përmes pyetësorëve, bisedave me ta, pjesëmarrjes në mbledhjet e ekipeve lëndore, vizitave në institucionet arsimore, vëzhgimeve të orëve mësimore, kryerjes me nxënësit të testeve të standardizuara e minitesteve, takimeve me prindër e nxënës e me organizma që i përfaqësojnë ato, me përfaqësues të tjerë të komunitetit.
- c) Merr informacion mënyr nga shkollat mbi gjendjen e mjeteve elektronike të TIK-ut dhe të laboratorëve të kompjuterëve, verifikon gjendjen dhe raporton në DRAP dhe DPAP.
- d) Ndjek plotësimin nga shkollat të parapëlqimeve të nxënësve në kurrikulën me zgjedhje.
- e) Verifikon saktësinë e plotësimit të amzës së digitalizuar nga shkollat.
- f) Grumbullon të dhënat statistikore nga institucionet arsimore sipas kërkesave të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe kërkesave të DRAP dhe DPAP.
- g) Përpunon të dhënat për renditjen e institucioneve arsimore.

Neni 36
Raportimi

- a) Secila ZVAP harton planin afatmesëm dhe vjetor të punës i cili miratohet nga Drejtori i DRAP, si dhe raportin vjetor të veprimtarisë të cilin e paraqet në DRAP.
- b) Raporti vjetor i secilës ZVAP u dërgohet DRA-ve dhe DPAP-së.
- c) ZVAP-ja zhvillon analizën vjetore me pjesëmarrjen e drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniveristar publik dhe privat, si dhe me përfaqësues të sindikatave, OFJ-ve dhe enteve publike dhe jopublike të tjera që veprojnë në fushën e arsimit parauniveristar, në territorin nën juridikSIONIN e tyre.


Neni 37
Faqja zyrtare

- a) ZVAP-ja ka faqen e saj zyrtare elektronike.
- b) ZVAP-ja publikon në faqen zyrtare të saj të dhënat për arsimin parauniversitar.
- c) ZVAP-ja publikon të dhëna të provimeve kombëtare e ndërkombëtare.
- d) ZVAP-ja publikon raportin vjetor në faqen zyrtare të internetit.

- e) ZVAP-ja publikon rregullisht në faqen e internetit përvojat e suksesshme të institucioneve arsimore drejtuesve dhe mësuesve.
- f) Shpall listën e Portalit Mësues për Shqipërinë.

Neni 38
DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

1. Sekretari i Përgjithshëm në MASR, DPAP, DRAP dhe ZVAP, ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje.
2. Në rast mbivendosje kompetencash, si pasojë e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, struktura që konstaton mbivendosjen i kërkon MASR-së, përcaktimin e strukturës kompetente për zbatimin e kompetencës së mbivendosur.

Konceptoi:	R. Merdani A. Celaj		
Miratoi:	E. Tola		
Miratoi:	Z.Gjini		
Konfirmoi:	O. Muzaka		